



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.1-4/2018

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi duke vendosur lidhur me apelin e subjektit politik Fronti Demokratik për Bashkim Kombëtar (FDBK) me seli në Klinë, paraqitur kundër vendimit të PZAP-it, me numër Anr.01/2018 të datës 16.01.2018, për rishikim të vendimit, për shkak të çregjistrimit të subjektit politik nga Regjistri i Partive Politike të Regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në seancën e panelit të mbajtur me 24.01.2018, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar Kërkesa për Rishikim të vendimit Anr.1-4/2018 e datës 19.01.2018, e parashtruar nga subjekti politik Fronti Demokratik për Bashkim Kombëtar (FDBK), me seli në Klinë.

A r s y e t i m

Më datë 19.01.2018, Fronti Demokratik për Bashkim Kombëtar (FDBK) me seli në Klinë, ka parashtruar apel kundër vendimit të PZAP-it me nr. Anr.01/2018 të datës 16.01.2018, me të cilën pretendon se posedojnë fakte të reja të cilat pas prezantimit të tyre do të ndikojnë në ndryshimin e vendimit lidhur me çregjistrimin e subjektit politik FDBK.

Me këtë rast parashtruesi i apelit, pretendon se KQZ-ZRPPC ka njoftuar subjektin e tyre politik përmes postës elektronike lidhur me vendimin, mirëpo këtë njoftim sipas tyre nuk e kanë pranuar në email adresën e tyre.

Parashtruesi i apelit si dëshmi ka bashkangjitur:

- Njoftimin e dërguar përmes postës elektronike të KQZ-së, tek kryetari i subjektit politik FDBK, Hysni Elshani.
- Fotokopjen e pasaportës së personit kontaktues të subjektit politik FDBK, Hysni Terziu.

Në përgjigjen e ofruar nga ZRPPC, me nr. Protokolli 114/2018 të datës 24.01.2018, thekson se komunikimi i Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike me subjektin politik Fronti Demokratik për Bashkim Kombëtar (FDBK), që ka të bëjë me dorëzimin e vendimit me numër 58/2018 të datës 12.01.2018, për çregjistrimin e këtij subjekti politik, është bërë përmes postës elektronike-email-it. Më tej në përgjigje thuhet se Zyra në këtë mënyrë të komunikimit, i njofton të gjitha subjektet politike rreth aktiviteteve që ndërliohen me afatet ligjore, dhe se ky email i dërgohet kryetarit të subjektit politik dhe personit kontaktues të potë njëjtës parti.

ZRPPC, në përgjigjen e saj si dëshmi ka bashkangjitur:

- Njoftimet elektronike lidhur me komunikimin e vendimit të KQZ-së me FDBK.

PZAP-i, pas administrimit të pretendimeve në apel, si dhe mënyrën e njoftimit të palës të datës 23.11.2017 dhe 12.01.2018 cila iu është bashkangjitur në përgjigjen në apel të KQZ-ZRPPC-së gjeti se:

Apeli është i pabazuar:

Paneli konstaton se pretendimet ankimore të parashtruesit janë të pabazuara pasi që neni 118.4 i LZP-së përcakton se mund të apelohe vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar apo edhe për shkak të vullnetit të mirë të treguar. Mirëpo, paneli konstaton se apeli është i pabazuar duke marrë parasysh se komunikimi i parashtruesit të apelit me ZRPPC ka qenë i rregullt por që email-i i dorëzuar tek kryetari i subjektit politik FDBK ka dështuar të dërgohet për shkak të problemeve teknike të email adresës së tij, por me gjithë at subjekti politik subjekti politik FDBK është njoftuar përmes email-it te personi kontaktues Hysni Tërziu edhe pse i njëjti ka qenë në një vizitë jashtë vendit në kohën e marrjes së vendimit për pezullimin e subjektit politik kjo nuk do të thotë që nuk është dashtë të ndërmerren veprime konform vendimit të KQZ-së, që ka pas të bëjë me pezullimin e aktivitetit të subjektit politik në një afat kohor prej 45 ditëve..

Bazuar në këto që u theksuan më lartë PZAP konstaton se parashtruesi i apelit, pretendimet e tij në kërkesën për rishikim të vendimit, si dhe provat të cilat i ka ofruar si dëshmi për të vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli të merr vendim në favor të tij, nuk qëndrojnë pasi që subjekti politik në fjalë ka mundur të veproj sipas afatit të përcaktuar me vendimin e KQZ-së për mbajtjen e kuvendit zgjedhor, dhe se pretendimet e parashtruara në apel janë të pabazuara.


Për arsyet e cekura si më lartë e në pajtim me nenin 115.1 lidhur më nenin 118.1 të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 1-4/2018 më datën 24.01.2018

Kryesuesi i Panelit

Hasan Shala



Udhëzim Juridik: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme në afat prej 24 orëve nga dita e pranimit të njëjtit.